



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-194/1**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-194/2**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashetrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



Nr. Ref. BD-194/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe në bazë të Rregullorës Nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në AKP-ë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 29 dhjetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet plotësim ndryshimi i kushteve, përshkrimit të pozitës, detyrat dhe përgjegjësit për pozitën Zëvendës Drejtor Ekzekutiv për Funksione operative dhe Zëvendës Drejtor Ekzekutiv për Funksione të përgjithshme.**
- II. Udhëzohet Menaxhmenti/Divizioni i Burimeve Njerëzore të vazhdojë me publikimin e konkursit të rekrutimit.**
- III. Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin për plotësim ndryshim të Përshkrimit të Punës - Termave të referencës për pozitën e Zëvendës Drejtorëve Ekzekutiv sipas Strukturës së re Organizative që dop të hyjë në fuqi me datë 01 tetor 2023, si në vijim: 1) Funksione operative dhe 2) Funksione të përgjithshme dhe çështja e shpalljes së konkursit për rekrutimin e tyre.

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit duke u bazuar në kompetencat e veta ligjore, me datë 28 shtator 2023 përmes vendimit nr. ref. BD-187-4 kishte vendosur për ndryshimin e TeR për Drejtorin Ekzekutiv, dhe Zëvendës Drejtorët Ekzekutiv (ZDE): Operativë dhe Funksione të Përgjithshme në mënyrë që të jenë në përputhje me strukturën e re organizative që ka hyrë në fuqi me datë 01 tetor 2023. Poashtu Bordi në këtë mbledhje kishte vendosur që të shpallë konkurs publik rekrutues për dy ZDE-të. Sa i përket kësaj çështje është marrë vendim emergjent nr.ref.BD-194/1 për anulim të konkursit për pozitën e dy ZDE-ve nga Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja arsyetimi është se duke qenë se janë zhvilluar diskutime lidhur me amendamentimin e mundshëm të Strategjisë përmbyllëse të mandatit të Agjencisë për vitin e ardhshëm dhe rrjedhimisht shfaqet nevoja për ndryshim të Termave të referencës së Zëvendës drejtorëve ekzekutiv Operativë dhe Funksione të përgjithshme, të cilat tani po amendamentohen. Bordi shqyrtoi Termet e Referencës për pozitën e dy ZDE-ve: 1) Funksione operative dhe 2) Funksione të përgjithshme dhe vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 dhjetor 2023


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-194/4

Në bazë të neneve 6A dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Vendimit përfundimtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/173 të datës 16 nëntor 2023, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 29 dhjetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Autorizohet Drejtori Ekzekutiv i AKP-së që të nënshkruaj "Marrëveshjen e Mirëkuptimit" me Ministrinë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI për pagesën e shpronësimit të pronës të paluajtshme parcela kadastrale nr.2307-2 ZK Suharekë - Njësia Damber të PRZ014 NSh IGK Ballkani, Suharekë në shumën 4,205,680.00 € (shuma totale e vlerësimit të pronës) me pesë (5) këste, sipas planit Dinamik deri në fund të vitit 2024.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovim të draft Marrëveshjes së Mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI për pagesën e shpronësimit me këste për pronë e paluajtshme pronën e paluajtshme parcela kadastrale nr.2307-2 ZK Suharekë, Suharekë pronë e PRZ014 NSh IGK Ballkani - Njësia Damber, Suharekë.

Më datë 16 nëntor 2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin Përfundimtar me nr. 04/173 përmes së cilit është miratuar shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme: parcela kadastrale nr.2307-2 ZK Suharekë, Suharekë pronë e PRZ014 NSh IGK Ballkani - Njësia Damber, Suharekë, për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve e ka bërë vlerësimin e pronës së paluajtshme të PRZ014 NSh IGK Ballkani - Njësia Damber, Suharekë në vlerën 4,205,680.00 €. Detajet mbi marrëveshjen dhe dinamikën e pagesës që ndërlihet me shpronësimin e pronave janë paraqitur në memorandum për pikën 2.4 të agjendës së kësaj mbledhje 29.12.2023
Qëllimi i lidhjes së Marrëveshjes së Mirëkuptimit është rregullimi i dinamikës së pagesës së shumës së 20% në emër të shpronësimit

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 dhjetor 2023.



Mentor Hysni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit